



VENDIM

Nr. 39 Datë 23.04.2012

PER

MIRATIMIN E UDHEZUESIT PËR MENAXHIMIN DHE ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË PROJEKTIN TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP), SIPAS PARAGRAFIT 6, TË NENIT 36 TË DIREKTIVËS 2009/73/EC

Në mbështetje nenit 40, të Ligjit nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe neni 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE–s, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 17.10.2011 të Bordit të Komisionerëve, dhe vendimin nr 155, datë 19.12.2011, për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga aksesit i palëve të treta të paraqitur nga ana e kompanisë TAP AG, duke marre parasysh gjithashtu qe:

- Direktiva 2009/73/EC është e zbatueshme për Italinë dhe Greqinë, si Shtete Anëtare të Bashkimit Europian dhe është transpozuar në legjislacionin përkatës kombëtar të këtyre vendeve, dhe
- Direktiva 2003/55/EC është e zbatueshme për Shqipërinë si Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe është transpozuar në legjislacionin kombëtar.
- Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë ka vendosur më 6 tetor, 2011, që Direktiva 2009/73/EC dhe Rregullorja 715/2009, do të duhet të zbatohen nga të gjitha Palët Kontraktuese brenda vitit 2015.
- Neni 22, i Direktivës 2003/55/EC, Neni 36 i Direktivës 2009/73/EC dhe legjislacioni kombëtar, kërkojnë që në rastin kur infrastruktura në fjalë shtrihet në territorin e me shume së një vendi, çdo vendim për përjashtim prej të drejtës së aksesit te palëve te treta, (TPA) duhet të merren në bashkëpunim mes Autoriteteve Kombëtare të vendeve përkatëse.

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.04.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me drat Udhëzuesin që ka rezultuar prej bashkëpunimit të tre rregullatorëve,

Vendosi:

1. Miratimin e Udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6, të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.